



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:728/25 Datë:20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Fakultetit të Shkencave Islame Prot:317/25 e datës 22.05.2025 për zgjatjen për një vit të akreditimit të programit:

- *Teologji Islame, BA, 240 ECTS*

II. Mbetet në fuqi vendimi i KShC-së Ref.: 2406/25 datë 22.11.2024.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA), me datë 22.05.2025 ka pranuar kërkesën e Fakultetit të Shkencave Islame, me Prot:317/25, për zgjatjen e akreditimit të programit "*Teologji Islame*", BA, 240 ECTS për një vit.

Kërkesa është bërë me arsyetimin se, citojmë: *Fakulteti i Studimeve Islame është themeluar dhe funksionon vazhdimisht që nga viti 1992. Megjithatë, në vitin 2012, FIS është akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës dhe ka vazhduar me akreditimin deri më sot. Akreditimi i tij i fundit është i vlefshëm deri më 30 shtator 2025. Fakulteti i Studimeve Islame mbetet i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë i dedikuar studimeve islame, i trashëguar nga periudha e paralufës që nga viti 1992, duke ofruar programe akademike për stafin fetar që shërben si në vendin tonë ashtu edhe jashtë vendit.*

Në korrik të vitit të kaluar (2024), Fakulteti i Studimeve Islame aplikoi për riakreditim institucional, si dhe për riakreditimin e të dy programeve të tij të studimit, pra programeve Bachelor dhe Master. Procesi i riakreditimit institucional është përfunduar me sukses dhe jemi të riakredituar deri më 30 shtator 2028. Sa i përket programit të nivelit MA, vizita e vlerësimit është kryer dhe aktualisht po presim vendimin përfundimtar.

Shqetësimi ynë qëndron te programi i nivelit BA "Teologji Islame". Arsyeja e refuzimit është numri i pamjaftueshëm i botimeve nga mbajtësit e programit në revista shkencore me faktor ndikimi, deri në këtë pikë. Megjithatë, arsyeja kryesore pas kësaj mungese të botimeve të përmendura është dalja në pension e

Faqe 1 nga 3

disa stafit akademik dhe dalja në pension e disa të tjerëve vitin e ardhshëm. Mbajtësit e programit të sapoemëruar tashmë kanë botuar punën e tyre akademike, por emrat e tyre ende nuk janë shfaqur në platformën SCOPUS.

Për programin "Teologji Islame", BA, 240 ECTS, janë propozuar pesë bartës për të cilët FSI jep përshkrimin dhe sqarimet në kërkesë...

Tutje FSI arsyeton se: ...është i përkushtuar për të përmbushur këtë kërkesë dhe ka ndërmarrë iniciativë duke ofruar ndihmë në trajnime dhe mbështetje financiare. Gjithashtu, revista e botuar nga FSI, BULETINI, ka marrë numrin ISSN dhe së fundmi është indeksuar në bibliotekën dixhitale CEEOL: (<https://www.ceeol.com/search/journal-detail?id=4345>). Kjo përfaqëson një mundësi dhe motivim të rëndësishëm për të gjithë stafin e FSI-së, si dhe për kontribuesit e jashtëm, për të kryer dhe publikuar kërkime në një revistë të rishikuar nga kolegët dhe të pranuar ndërkombëtarisht. Për informacionin tuaj, aktualisht jemi në procesin e indeksimit të revistës sonë BULETINI në EBSCO, aplikimi është bërë.

Gjatë vizitës së riakreditimit institucional nga ekipi ndërkombëtar i ekspertëve, çështja e botimeve të stafit u diskutua dhe u trajtua në raportin e tyre (faqet 21-22), i cili vlerësoi pozitivisht angazhimin tonë për të mbështetur botimet akademike. Kjo përfshin organizimin e sesioneve të trajnimit mbi metodologjinë e kërkimit dhe botimet akademike, me fokus në SCOPUS dhe Web of Science. FIS gjithashtu ka mbështetur stafin e tij duke mbuluar kostot e botimit. Raporti i ekspertëve theksoi një përmirësim të qartë në këtë drejtim krahasuar me vizitën e tyre të mëparshme.

Raporti gjithashtu theksoi sfondin unik akademik të institucionit tonë, duke vënë veçanërisht në dukje se stafi akademik ka marrë arsimimin e tyre kryesisht në mjedise akademike jo-perëndimore, gjë që është një pengesë gjuhësore dhe më pak mundësi për të botuar në arabisht.

Prandaj, duke marrë parasysh rolin thelbësor që Fakulteti i Studimeve Islame luan në Kosovë si i vetmi institucion që ofron Islam Studimet e mikrofonit në gjuhën tonë amtare dhe kontekstin kulturor, shpresojmë singërisht që Bordi i KShC do t'i marrë parasysh këto rrethana dhe misionin dhe rëndësinë specifike të fakultetit tonë dhe do të miratojë kërkesën tonë për një zgjatje të akreditimit të programit BA deri më 3 shtator 2026. Jemi shumë të bindur se deri në atë kohë nuk do të kemi probleme me botimet e stafit tonë akademik në revistat përkatëse.

Ne besojmë se riakreditimi i këtij programi dhe sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të Fakultetit të Studimeve Islame është shumë i rëndësishëm për shkak të rëndësisë jetike për shoqërinë dhe institucionet tona, për shkak të rolit të rëndësishëm të fakultetit në përgatitjen e burimeve njerëzore fetare në përputhje me kontekstin tonë kulturor dhe intelektual."

AKA ka proceduar kërkesën për shqyrtim në mbledhjen e 138-të të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, mbajtur me datë 16.06.2025, e cila konstaton se : sipas paragrafit 3 të nenit 27 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, citojmë

"Në rast se institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë për akreditim ose riakreditim të ndonjë programi studimor i cili me vendim të Qeverisë ose në bazë të ndonjë dokumenti strategjik shtetëror vlerësohet si program me interes nacional mund të akreditohet nga KShC me kusht për një periudhë një (1) vjeçare edhe nëse nuk e plotëson ndonjërin nga standardet e akreditimit."

...në të kundërtën sipas paragrafit 1 të po këtij neni; "Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private, që funksionojnë në Kosovë dhe që ofrojnë programe të studimit që shpijnë tek marrja e një diplome akademike dhe-apo profesionale, mund të jenë kandidatë për akreditim.", që nënkupton se për të ofruar një program, IAL duhet ti nënshtrohen procesit të ri/akreditimit.

Për sqarim tutje, KShC kishe refuzuar aplikacionin për programin "Teologji Islame", BA, 240 ECTS, vendimi i KShC-së Ref.: 2406/25 datë 22.11.2024 me arsyetimin se : bartësi Rexhep Suma Doktorata e parë nuk është e fushës, Doktoratës së dytë i mungon nostrifikimi, ndërsa bartësit Sulejman Osmani, Ilmije Kuqi, Bahri Hoxha dhe Valmire Batatina Krasniqi nuk i kanë publikimet ashtu siç kërkohet me Rregulloren (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit përkatësisht nenin 12, paragrafin 4 të kësaj rregulloreje, ku thuhet citojmë: " Përveç kritereve të përcaktuara nga aktet nënligjore administrative në fuqi, bartësit e programit që hyjnë në procesin e akreditimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën një publikim shkencor në fushën e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc bartësi i programit duhet të ketë të paktën dy publikime shkencore nga fusha e programit të studimit të botuara në pesë vitet e fundit. Në mënyrë që këto publikime të njihen, revista përkatëse duhet të jetë e indeksuar në WEB OF SCIENCES ose SCOPUS dhe bartësi i programit të renditet si autori i parë ose autor korrespondues. Në një publikim të bashkë-autorizuar nga dy autorë, ku autori korrespondues nuk përmendet qartë nga publikimi apo revista, për qëllimet e këtij manuali autori i dytë do të konsiderohet si autori korrespondues."

KShC ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin e referuar në kërkesë dhe pas analizimit të dokumenteve relevante dhe bazës ligjore, konstatoi se në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e Ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Islame;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.